

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**40 HADITHE
RRETH
NAMAZIT TË NATËS**

Tiranë, 2026

Titulli: 40 Hadithe rreth namazit të natës

Marrë nga: www.hadithlib.com

**I Përzodhi dhe i përktheu nga persishtja:
Sabrie FEZA**

I redaktoi: Jerida KULLA

I korrekttoi: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie FEZA

Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: Fondacioni i Kur'anit'' - Tiranë, 2026

Rëndësia e Namazit të Natës

**Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Ka momente në jetën e njeriut kur heshtja e natës bëhet më e fuqishme se zhurma e ditës. Kur njerëzit flenë, rrugët qetësohen dhe bota duket sikur ndalet për pak çaste, besimtari ka mundësinë të ngrihet nga shtrati dhe të qëndrojë vetëm përpara Krijuesit të tij.

Ky është namazi i natës – *Salatul-Lejl*, një prej adhurimeve më të çmuara dhe më të dashura në traditën islame.

Namazi i natës nuk është thjesht disa rekate që falen në orët e vona. Ai është një takim i fshehtë mes robit dhe Allahut, një moment pendimi, lutjeje, falënderimi dhe afrimi me Të.

Namazi i natës në Kur'an

Kur'ani e përmend adhurimin gjatë natës dhe e paraqet atë si një prej cilësive të njerëzve të devotshëm.

Allahu i Madhëruar thotë:

كَانُوا قَلِيلًا مِّنَ اللَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ ﴿٢٠٠﴾ وَبِالْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

“Ata flinin pak gjatë natës dhe në agim kërkonin falje (nga Allahu)”¹

Ky përshkrim na zbulon një nga tiparet e njerëzve të devotshëm: ata nuk e

¹ Sure “Ed-Dhariat”, ajetet 17-18.

kalonin tërë natën në gjumë, por e shfrytëzonin një pjesë të saj për adhurim dhe për të kërkuar faljen e Allahut.

Në traditën e transmetimeve të Ehli Bejtit, Imam Xhafer Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) e ka komentuar këtë ajet duke thënë se ata flinin vetëm një pjesë të natës, pasi nuk e linin vazhdimisht namazin e natës. Ky koment është transmetuar në veprën “El-Kafi” dhe është përcjellë, gjithashtu, edhe në burime të mëvonshme të tefsirit.

Në një tjetër vend, Allahu i Madhëruar thotë:

تَجَافَى جُنُوبَهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë ...”²

Dhe, menjëherë, pas kësaj Allahu thotë:

فَلَا تَعْلَمُ نَفْسٌ مَّا أُخْفِيَ لَهُم مِّن قُرَّةِ أَعْيُنٍ جَزَاءِ بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ

“Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë”.³

Këto ajete janë ndër argumentet më të bukura, kur flitet për vlerën e adhurimit të natës.

² Sure “Es-Sexhde”, ajeti 16.

³ Po aty, ajeti 17.

***Një urdhër i veçantë për Profetin Muhamed
(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe
familjen e tij!)***

Në suren “El-Muzzemmil”, në ajetet 1-4, Allahu i drejtohet Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!):

يَا أَيُّهَا الْمُرْسَلُ ﴿۱﴾ قُمْ اللَّيْلَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿۲﴾ نِصْفَهُ أَوْ انْقُصْ مِنْهُ قَلِيلًا ﴿۳﴾ أَوْ
زِدْ عَلَيْهِ وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا ﴿۴﴾

“O ti i mbuluar (o Muhamed)! Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo dhe lexoje Kur’anin ngadalë dhe qartë”.

Gjithashtu, Allahu thotë:

وَمِنَ اللَّيْلِ فَسَجُدْ لَهُ نَافِلَةً لَّكَ عَسَىٰ أَن يَبْعَثَكَ رَبُّكَ مَقَامًا مَّحْمُودًا

“Kaloje një pjesë të natës, si falje shitesë për ty (Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar”.⁴

Ky është një prej ajeteve më të rëndësishme për të kuptuar pozitën e namazit të natës.

⁴ Sure “Isra”, ajeti 79.

Çfarë ka thënë Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)?

Në burimet e transmetimeve islame gjenden shumë fjalë që nxisin adhurimin gjatë natës.

Në një transmetim nga Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) thuhet: *“Dy rekate në mes të natës janë më të dashura për mua sesa dynjaja dhe gjithçka që gjendet në të”*.⁵

Kjo na tregon se vlera e namazit të natës nuk matet vetëm me numrin e

⁵ “Uesailu Shia”, vëll. 5, f. 276.

rekateve, por me afrimin që ai krijon ndërmjet robit dhe Allahut.

Në një tjetër transmetim të njohur, thuhet: *“Nderi i besimtarit është namazi i tij i natës, ndërsa krenaria e tij është përmbajtja e tij nga cenimi i nderit të njerëzve”*.⁶

Mesazhi i tij është shumë i rëndësishëm: adhurimi i natës duhet të shoqërohet me moral të mirë dhe respekt ndaj njerëzve.

Në disa burime transmetohet se Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) e këshilloi

⁶ “El-Kafi”, vëll. 2, f. 148, si dhe në “Uesailu Shia”, vëll. 5, f. 269.

Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) ta kryente namazin e natës, duke e përsëritur këshillën: *“Të këshilloj ta kryesh namazin e natës! Namazin e natës! Namazin e natës!”*

***Namazi i natës në fjalët e Ehli Bejtit
(Paqja qoftë mbi ta!)***

Një prej transmetimeve më të bukura tregon se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Që kur dëgjova Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) të thoshte: ‘Namazi i natës është dritë’, nuk e kam lënë namazin e natës”.

Kur u pyet, nëse edhe në natën e Haririt, gjatë betejës së Sifinit, e kishte lënë, ai u përgjigj se as atë natë nuk e kishte lënë.⁷

Sa domethënëse janë këto fjalë: “*Namazi i natës është dritë*”. Dritë në zemër,

⁷ “Biharul Enuar”, vëll. 41, f. 17, Hadithi 10.

dritë në shpirt dhe, sipas transmetimeve, dritë për Botën Tjetër.

Imam Ali ibn Hysen Zejnul-Abidini (Paqja qoftë mbi të!), i njohur për adhurimin dhe lutjet e tij të shumta, u pyet: *“Përse ata që falin namazin e natës, janë ndër njerëzit me fytyrat më të bukura?”*

Ai u përgjigj: *“Sepse ata vetmohen me Allahun dhe Allahu i vesh me dritën e Tij”.⁸*

Kjo është një prej pamjeve më të bukura të namazit të natës: njeriu qëndron vetëm me Allahun, pa njerëz që ta shohin,

⁸ “Ilal esh-Sherai” i Shejkh Sadukut, vëll. 1, f. 366.

pa duartrokitje dhe pa lavdërime. Është adhurimi më i sinqertë.

Nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) përcillet: *“Nderi i besimtarit është namazi i tij i natës”*.⁹

Në një tjetër transmetim nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) thuhet: *“Mos e lër namazin e natës, sepse i privuari është ai që privohet nga namazi i natës”*.¹⁰

Sa bukur e ka argumentuar Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) rëndësinë e namazit të natës- njeriu mund të privohet nga namazi i natës për shkak të mëkatit;

⁹ “El-Kafi”, vëll. 2, f. 148.

¹⁰ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 146.

madje përmendet edhe gënjeshtër si një shkak i tillë. Kjo nuk duhet të kuptohet si arsye për t'u dëshpëruar. Përkundrazi, duhet të jetë një thirrje për pendim. Nëse zemra është rënduar, njeriu duhet të kthehet te Allahu. Edhe një sexhde e sinqertë në heshtjen e natës mund të jetë fillimi i një ndryshimi të madh në jetën e tij.

Namazi i natës përbëhet nga 11 rekate:

- 8 rekate (pas çdo dy rekatesh jepet selam) – Salat-ul-Lejl;
- 2 rekate – Shaf'i;
- 1 rekat – Vitr.

Namazi i natës dhe pastrimi i shpirtit

Një prej problemeve më të mëdha të njeriut modern është se ka shumë zhurmë, por pak qetësi. Ka shumë njerëz rreth nesh, por pak momente kur jemi vetëm me veten. Namazi i natës e rikthen këtë ekuilibër. Kur njeriu ngrihet në orën kur të gjithë flenë, merr abdes, qëndron në këmbë përpara Allahut të madhëruar dhe lexon Kur'an, ai fillon të dëgjojë gjërat që gjatë ditës nuk i dëgjon dot. Dëgjon zemrën e vet. Kujton gabimet e tij. Kërkon falje. Falënderon Allahun. Lutet për familjen. Lutet për prindërit. Lutet për njerëzit që vuajnë. Dhe mbi të gjitha, kujton se nuk është vetëm.

Koha më e mirë është pjesa e fundit e natës, veçanërisht afër agimit (koha e syfyrit - para se të hyjë koha e sabahut).

Kur'ani i përshkruan njerëzit e devotshëm:

وَبِالْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

“Dhe në kohën e agimit ata kërkonin falje”.¹¹

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka transmetuar se Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) kërkonte falje 70 herë në namazin e Vitrit. Kjo na mëson një mësim të madh. Sa

¹¹ Sure “Edh-Dhariat”, ajeti 18.

më afër Allahut të jetë njeriu, aq më shumë e ndien nevojën për faljen e Tij.

Mos prit të bëhesh i përsosur. Një gabim që mund të bëjë dikush, është të mendojë: “Unë kam shumë mëkate. Nuk jam në nivelin e njerëzve që falin namazin e natës”. Por pikërisht, për këtë arsye duhet të kthehesh te Allahu. Namazi i natës nuk është vetëm për njerëzit që janë tashmë të përsosur. Ai është edhe rrugë për t’u pastruar. Nëse nuk mundesh ta fillosh me 11 rekate, fillo me dy. Nëse nuk mund të zgjohesh shumë herët, fillo më pak më herët se zakonisht. Nëse nuk mund të lutesh gjatë, thuaj vetëm disa fjalë të sinqerta. Sepse qëllimi nuk është vetëm

sasia, por sinqeriteti, vazhdimësia dhe afrimi me Allahun e Madhëruar.

Namazi i natës është një prej thesareve më të mëdha të adhurimit islam.

Kur'ani na tregon për njerëzit që largohen nga shtretërit e tyre dhe e lusin Allahun me frikë dhe shpresë.

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) e ka nxitur këtë adhurim në transmetime të shumta.

Prandaj, kur nata bie dhe njerëzit pushojnë, mos e shiko vetëm si kohën për të fjetur. Ndoshta është një mundësi që Allahu ta ka dhënë për të folur me Të.

Ngrihu.

Merr abdes.

Falu.

Qëndro pak në sexhde.

Dhe fol me Allahun për gjithçka që ke në zemër, sepse ndonjëherë lutja që nuk ia tregon dot askujt, është pikërisht lutja që Allahu dëshiron ta dëgjojë prej teje.

O Allah, na bëj prej atyre që e duan namazin e natës, na zgjo për të të përmendur Ty, na fal mëkatet tona, ndriçoji zemrat tona dhe na bashko me Muhamedin dhe familjen e tij të pastër!

Sabrie Feza

40 HADITHE RRETH NAMAZIT TË NATËS

Rëndësia e namazit së natës

Hadithi 1

Dashuria ndaj namazit të natës

Enes ibn Maliku tregon: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) të thotë: “*Dy rekate namaz në mes të natës janë më të dashura për mua, sesa dynjaja dhe gjithçka që gjendet në të*”.¹²

عَنْ أَنَسِ بْنِ مَالِكٍ سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ يَقُولُ: الرَّكَعَتَانِ فِي جَوْفِ اللَّيْلِ أَحَبُّ إِلَيَّ مِنَ الدُّنْيَا وَمَا فِيهَا. (بخار الأنوار، ج 87، ص 148).

¹² “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 148.

Hadithi 2

Stolia e Botës së Përtejme

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Pasuria dhe fëmijët janë stolia e jetës së kësaj bote, ndërsa tetë rekate namaz në fund të natës dhe namazi i vitrit janë stolia e Botës së Përtejme. Allahu mund t’ua bashkojë të gjitha këto stoli disa njerëzve”*.¹³

عَنْ جَعْفَرِ بْنِ مُحَمَّدٍ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: أَمَّا الْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَتَبَائِنُ
رَكَعَاتٍ مِنْ آخِرِ اللَّيْلِ وَالْوُتْرُ زِينَةُ الْآخِرَةِ، وَقَدْ يَجْمَعُهَا اللَّهُ لِأَقْوَامٍ. (بخارالأنوار،
ج 87، ص 150).

¹³ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 150.

Hadithi 3

Shenja e dashurisë së Allahut

Xhabir ibn Abdullah el-Ensariu ka thënë se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) të thotë: “Allahu i Lartësuar nuk e zgjodhi Ibrahimin (Paqja qoftë mbi të!) si mik të Tij të ngushtë, përveçse për shkak të dy veprave: ushqimit që u jepte njerëzve dhe namazit që falte natën, ndërsa njerëzit ishin në gjumë”.¹⁴

عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ الْأَنْصَارِيِّ قَالَ : سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ يَقُولُ: مَا اتَّخَذَ اللَّهُ إِبْرَاهِيمَ خَلِيلًا إِلَّا لِإِطْعَامِهِ الطَّعَامَ، وَصَلَاتِهِ بِاللَّيْلِ وَالنَّاسِ نِيَامًا. (بحار الأنوار، ج 87، ص 144).

¹⁴ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 144.

Hadithi 4

Shkëq i lumturisë

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Më i miri prej jush është ai që flet bukur, ushqen të tjerët dhe fal namaz natën, ndërsa njerëzit janë në gjumë”.¹⁵

قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: خَيْرُكُمْ مَنْ أَطَابَ الْكَلَامَ وَأَطْعَمَ الطَّعَامَ وَصَلَّى بِاللَّيْلِ وَالتَّائِبُ نِيَامٌ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 142).

¹⁵ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 142.

Hadithi 5

Namazi më i mirë

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “*Namazi më i mirë, pas namazit të detyrueshëm, është namazi në mes të natës*”.¹⁶

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ قَالَ: أَفْضَلُ الصَّلَاةِ بَعْدَ الصَّلَاةِ الْمَكْتُوبَةِ الصَّلَاةُ فِي جَوْفِ اللَّيْلِ. (كنز العمال، 21397/7).

¹⁶ “Kenzul Ummal”, vwll. 7, hadithi 21397

Hadithi 6

Më i vlefshëm se bota

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “*Dy rekate që biri i Ademit i fal në pjesën e fundit të natës, janë më të mira për të, sesa dynjaja dhe gjithçka që gjendet në të. Sikur të mos ishte e vështirë për umetin tim, do t’ua bëja detyrim ato dy rekate*”.¹⁷

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ قَالَ: رَكْعَتَانِ يَرْكَعُهُمَا ابْنُ آدَمَ فِي جَوْفِ اللَّيْلِ الْآخِرِ خَيْرٌ لَهُ مِنَ الدُّنْيَا وَمَا فِيهَا، وَلَوْلَا أَنْ أَشُقُّ عَلَى أُمَّتِي لَفَرَضْتُهَا عَلَيْهِمْ. (كنز العمال، 21405/7).

¹⁷ “Kenzul Ummal”, vwll. 7, hadithi 21405.

Hadithi 7

Dyert e mirësisë dhe të lumturisë

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) i tha Muadh ibn Xhebelit gjatë betejës së Tebukut:

- *A dëshiron të të tregoj për dyert e mirësisë?*
- *Po, o i Dërguari i Allahut.*
- *Agjërimi është mburojë; sadakaja e shlyen mëkatin; ngritja e njeriut në mes të natës duke kërkuar kënaqësinë e Allahut. (Pastaj lexoi ajetin 16 të sures*

***“Sexhde”): “Ata ngrihen nga shtrati,
e i luten Zotit të tyre...”¹⁸***

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ لِمُعَاذِينَ جَبَلٍ فِي غَزْوَةِ تَبُوكَ: وَإِنْ شِئْتَ أَتْبِئْتُكَ بِأَبْوَابِ
الْخَيْرِ؟ قُلْتُ: أَجَلُ يَا رَسُولَ اللَّهِ قَالَ: الصَّوْمُ جُنَّةٌ، وَالصَّدَقَةُ تُكَفِّرُ الْخَطِيئَةَ، وَقِيَامُ
الرَّجُلِ فِي جَوْفِ اللَّيْلِ يَنْتَعِي وَجْهَ اللَّهِ، ثُمَّ قَرَأَ هَذِهِ الْآيَةَ: "تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ
يَدْعُونَ رَبَّهُمْ". (بخار الأنوار، ج 87، ص 123).

¹⁸ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f 123.

Hadithi 8

Porosia e Xhebrailit

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Xhebraili vazhdimisht më porosiste për namazin e natës, derisa mendova se njerëzit më të mirë të umetit tim nuk do të flinin gjatë netëve”.¹⁹

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَا زَالَ جِبْرِيلُ يُوصِينِي بِقِيَامِ اللَّيْلِ حَتَّى طَلَسْتُ أَنْ
خِيَارَ أُمَّتِي لَنْ يَنَامُوا. (بخارالأنوار، ج 87، ص 139).

¹⁹ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 139.

Hadithi 9

Një prej tri krenarive

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Tri gjëra janë krenari për besimtarin dhe stoli për të në këtë botë dhe në Botën e Përtejme: namazi në fund të natës; heqja dorë nga shpresa tek ajo që gjendet në duart e njerëzve; dhe pranimi i udhëheqjes së imamit nga familja e Muhamedit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)”.²⁰

يَقُولُ الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ: ثَلَاثَةٌ هُنَّ فَخْرُ الْمُؤْمِنِ وَزِينَةٌ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ:
الصَّلَاةُ فِي آخِرِ اللَّيْلِ، وَتَأْسُهُ مِمَّا فِي أَيْدِي النَّاسِ، وَوَلَايَةُ الْإِمَامِ مِنْ آلِ
مُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 140).

²⁰ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 140.

Hadithi 10

Nderi dhe madhështia e besimtarit

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Nderi i besimtarit është namazi i tij gjatë natës, ndërsa madhështia e tij është të përmbahet nga dëmtimi i njerëzve”.²¹

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ: شَرَفُ الْمُؤْمِنِ صَلَاتُهُ بِاللَّيْلِ، وَعِزُّهُ كُفُّ الْأَذَى عَنِ النَّاسِ.
(بحار الأنوار، ج 87، ص 141).

²¹ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 141.

Hadithi 11

Krenaria e Allahut ndaj engjëjve

Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *“Kur rob i ngrihet nga shtrati i tij i rehatshëm, ndërkohë që gjumi rëndon në sytë e tij, për të kënaqur Zotin e tij me namazin e natës, Allahu krenohet me të para engjëjve të Tij dhe thotë: ‘A nuk e shihni robin Tim? Ai është ngritur nga shtrati i tij i rehatshëm për një namaz që Unë nuk ia kam bërë detyrim. Jini dëshmitarë se e kam falur atë’”*.²²

²² “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 156.

عَنِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: إِذَا قَامَ الْعَبْدُ مِنْ لَذِيذِ مَضْجِعِهِ وَالثُّعَاسِ فِي عَيْنَيْهِ لِيَرْضَى رَبَّهُ جَلَّ وَعَزَّ صَلَاةَ لَيْلِهِ، بَاهَى اللَّهُ بِهِ مَلَائِكَتَهُ، فَقَالَ: أَمَا تَرَوْنَ عَبْدِي هَذَا، قَدْ قَامَ مِنْ لَذِيذِ مَضْجِعِهِ إِلَى صَلَاةٍ لَمْ أَفْزُضْهَا عَلَيْهِ إِشْهَدُوا أَنِّي قَدْ عَقَرْتُ لَهُ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 156).

Hadithi 12

Shpërblim pa kufi

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Nuk ka asnjë vepër të mirë që rob i kryen, për të cilën të mos ketë një shpërblim të përmendur në Kur’an, përveç namazit të natës. Allahu nuk e ka përcaktuar shpërblimin e tij, për shkak të madhësisë së tij tek Ai. Ai ka thënë: ‘Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në Jetën Tjetër), si shpërblim për punët e mira që

kanë bërë". (Sure "Es-Sexhde", ajetet 16-17)²³

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: مَا مِنْ عَمَلٍ خَيْرٍ يَعْمَلُهُ الْعَبْدُ إِلَّا وَابَّ فِي الْقُرْآنِ إِلَّا صَلَاةُ اللَّيْلِ فَإِنَّ اللَّهَ لَمْ يُبَيِّنْ ثَوَابَهَا لِعَظِيمِ خَطَرِهَا عِنْدَهُ فَقَالَ: «تَتَجَا فِي جُثُوبِهِمْ عَنِ الْمُضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ فَلَا تَعْلَمُ نَفْسٌ مَا أُخْفِيَ لَهُمْ مِنْ قُرَّةِ أَعْيُنٍ جَزَاءً بِمَا كَانُوا يَعْمَلُونَ». (وسائل الشيعة، ج 5، ص 281.)

²³ "Uesailu shia", vëll. 5, f. 281.

Hadithi 13

Edhe një rekat

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *“Përmbajuni namazit të natës, qoftë edhe vetëm me një rekat, sepse namazi i natës e ndalon njeriun nga mëkati, e shuan zemërimin e Zotit të Lartësuar dhe e largon nxehtësinë e Zjarrit nga njerëzit në Ditën e Kiametit...”*²⁴

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ قَالَ: عَلَيْكُمْ بِصَلَاةِ اللَّيْلِ وَلَوْ رُكْعَةً وَاحِدَةً، فَإِنَّ صَلَاةَ اللَّيْلِ مِنْهَاةٌ عَنِ الْأَثَمِ، وَتُطْفِئُ غَضَبَ الرَّبِّ تَبَارَكَ وَتَعَالَى، وَتَدْفَعُ عَنْ أَهْلِهَا حَرَّ النَّارِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ... (كنز العمال، 21431/7).

²⁴ “Kenzul Ummal”, vll. 7, hadithi 21431.

Hadithi 14

Ndjekësit e Ehli Bejtit dhe namazi i natës

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Nuk është prej shi’itëve (ndjekësve) tanë ai që nuk e fal namazin e natës”.²⁵

قَالَ الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ: لَيْسَ مِنْ شِيعَتِنَا مَنْ لَمْ يُصَلِّ صَلَاةَ اللَّيْلِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 162).

²⁵ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 162.

Hadithi 15

Zgjimi për namaz

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *“Allahu e mëshiroftë një burrë që ngrihet natën, fal namaz dhe zgjon gruan e tij që edhe ajo të falet; nëse ajo nuk zgjohej, ai i hedh pak ujë në fytyrë. Dhe Allahu e mëshiroftë një grua që ngrihet natën, fal namaz dhe zgjon burrin e saj; nëse ai nuk zgjohej, ajo i hedh pak ujë në fytyrë”*.²⁶

²⁶ “Mijzanul Hikmeh”, vëll. 5, Hadithi 10446.

40 hadithe

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: رَجِمَ اللَّهُ رَجُلًا قَامَ مِنَ اللَّيْلِ فَصَلَّى وَاتَّقَطَ إِمْرَأَتُهُ فَصَلَّتْ، فَلِنْ أَبَتْ نَضَحَ فِي وَجْهِهَا الْمَاءَ، رَجِمَ اللَّهُ إِمْرَأَةً قَامَتْ مِنَ اللَّيْلِ فَصَلَّتْ وَاتَّقَطَتْ زَوْجُهَا، فَلِنْ أَبِي نَضَحَتْ فِي وَجْهِهِ الْمَاءَ. (ميزان الحكمة، ج 5/10446).

Hadithi 16

Nijeti për namazin e natës

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Nuk ka rob që vendos në zemrën e tij të ngrihet për një pjesë të natës, por gjumi e mposht dhe ai nuk zgjohet, në këtë rast, gjumi i tij llogaritet si një sadaka që Allahu ia ka dhuruar, dhe Allahu ia shkruan shpërblimin e asaj që kishte pasur për qëllim”.²⁷

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَا مِنْ عَبْدٍ يُحَدِّثُ نَفْسَهُ بِقِيَامٍ سَاعَةٍ مِنَ اللَّيْلِ فَيَنَامُ عَنْهَا إِلَّا كَانَ تَوَمُّهُ صَدَقَةً تَصَدَّقَ اللَّهُ بِهَا عَلَيْهِ وَكُتِبَ لَهُ أَجْرُهَا نَوَى. (ميزان الحكمة، ج 10470/5)

²⁷ “Mijzanul Hikmeh”, vëll. 5, Hadithi 10470.

Hadithi 17

Ndikimet e namazit të natës dhe shlyerja e mëkateve

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Përmbajuni namazit të natës, sepse ai ishte tradita e të devotshmëve para jush. Ngritja gjatë natës e afron njeriun tek Allahu, e ndalon nga mëkati, i shlyen të këqijat dhe e largon sëmundjen nga trupi”.²⁸

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: عَلَيْكُمْ بِصَلَاةِ اللَّيْلِ فَإِنَّهُ ذَابُ الصَّالِحِينَ قَبْلَكُمْ، وَإِنَّ قِيَامَ اللَّيْلِ قُرْبٌ إِلَى اللَّهِ، وَمُنْهَاطٌ عَنِ الْإِثْمِ، وَكَفِيرُ السَّنَاتِ وَمَطْرَدَةٌ التَّاءِ فِي الْجَسَدِ.
(بحار الأنوار، ج 87، ص 123).

²⁸ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 123.

Dobitë e namazit të natës dhe shlyerja e gjynaheve

Hadithi 18

Dobitë e namazit të natës

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: “Ngritja gjatë natës është shëndet për trupin, kënaqësi për Zotin e Madhëruar, mundësi për t’u përfshirë në mëshirën e Tij dhe kapje pas moralit të profetëve”.²⁹

قَالَ أَمِيرُ الْمُؤْمِنِينَ عَلَيْهِ السَّلَامُ: قِيَامُ اللَّيْلِ مُصَحَّةٌ لِلْبَدَنِ، وَ مَرْضَاةٌ لِلرَّبِّ عَزَّ وَجَلَّ، وَ تَعْرِضُ
لِلرَّحْمَةِ وَ تَمْسُكُ بِأَخْلَاقِ النَّبِيِّينَ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 144).

²⁹ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 162.

Hadithi 19

Ndikimet e namazit të natës

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “*Namazi i natës e zbukuron fytyrën, e përmirëson moralin, e bën erën e njeriut të mirë, e shton furnizimin, shlyen borxhin, largon brengën dhe e ndriçon shikimin*”.³⁰

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: صَلَاةُ اللَّيْلِ تُحَسِّنُ الْوَجْهَ، وَتُحَسِّنُ الْخُلُقَ، وَتَطْيِبُ
الرِّيحَ، وَتَذِيرُ الزَّرْقَ، وَتَقْضِي الدَّيْنَ، وَتَذْهَبُ بِالْهَمِّ، وَتَجْلُو الْبَصَرَ. (وسائل الشيعة، ج 5،
ص 272).

³⁰ “Uesailu shia”, vëll. 5, f. 272.

Hadithi 20

Namazi i natës dhe drita e Allahut

Ali ibn Hyseni (Paqja qoftë mbi të!) u pyet: “Përse ata që zgjohen natën për adhurim janë ndër njerëzit me fytyrat më të bukura?” Ai tha: “Sepse ata veçohen me Zotin e tyre, ndaj Allahu i mbulon me Dritën e Tij”.³¹

سُئِلَ عَلِيُّ بْنُ الْحُسَيْنِ عَلَيْهِ السَّلَامُ : مَا بَالُ الْمُتَجِدِّينَ بِاللَّيْلِ مِنْ أَحْسَنِ النَّاسِ وَجْهًا؟ قَالَ:
لَا يَمُوتُ خَلْقًا يَرَاهُمْ فَكَسَاهُمُ اللَّهُ مِنْ نُورِهِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 159).

³¹ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 159.

Hadithi 21

Siguria e furnizimit

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Gënjen ai që pretendon se fal namazin e natës dhe mbetet i uritur, sepse namazi i natës siguron furnizimin e ditës.”*³²

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: كَذِبَ مَنْ زَعَمَ أَنَّهُ يُصَلِّي صَلَاةَ اللَّيْلِ وَهُوَ يَجُوعُ لَنَ صَلَاةِ اللَّيْلِ تَصْمِيْنُ رِزْقَ النَّهَارِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 154).

³² “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 154.

Hadithi 22

Shkallët e namazit të natës

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *“Atij robi, burrë apo grua, të cilit i është dhuruar namazi i natës dhe që ngrihet me singëritet për Allahun e Madhëruar, merr abdes të plotë dhe falet për Allahun me qëllim të singertë, me zemër të pastër, trup të përulur dhe sy të përlotur, Allahu i Lartësuar i vendos pas tij nëntë rreshta engjëjsh. Në çdo rresht ka aq shumë engjëj, sa askush, përveç Allahut nuk mund t'i numërojë. Njëri skaj i çdo rreshti është në lindje dhe tjetri në perëndim. Kur ai e përfundon namazin, Allahu i shkruan atij*

shkallë shpërblimi në numër sa numri i atyre engjëjve".³³

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَنْ زُرِقَ صَلَاةَ اللَّيْلِ مِنْ عَبْدٍ أَوْ أَمَةٍ قَامَ لِلَّهِ عَزَّوَجَلَّ مُخْلِصًا فَتَوْضًا وَضُوءًا سَابِغًا وَصَلَّى لِلَّهِ عَزَّوَجَلَّ بَيْتَهُ صَادِقَةً وَقَلْبٍ سَلِيمٍ وَيَدَيْنِ خَاشِعَتَيْنِ وَغَيْنٍ دَامِعَةٍ جَعَلَ اللَّهُ تَبَارَكَ وَتَعَالَى خَلْفَهُ تِسْعَةَ صُفُوفٍ مِنَ الْمَلَائِكَةِ فِي كُلِّ صَفٍّ مَا لَا يُحْصَى عَدَدُهُمْ إِلَّا اللَّهُ تَعَالَى أَحَدٌ طَرَفِي كُلِّ صَفٍّ فِي الْمَشْرِقِ وَالْآخِرُ بِالْمَغْرِبِ، قَالَ: فَإِذَا فَرَغَ كَتَبَ لَهُ بِعَدَدِهِمْ دَرَجَاتٍ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 137).

³³ "Biharul Enuar", vëll. 87, f. 137.

Hadithi 23

Begatia e namazit të natës

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Përmbajuni namazit të natës. Nuk ka rob që ngrihet në fund të natës, fal tetë rekate të namazit të natës, dy rekate Shaf’i dhe një rekat të vitrit dhe kërkon falje nga Allahu në kunut, shtatëdhjetë herë, Allahu e mbron nga dënimi i varrit dhe nga dënimi i zjarrit, ia zgjat jetën dhe ia zgjeron jetesën”. Pastaj tha: “Shtëpitë në të cilat falet namazi i natës, ndriçojnë për banorët

e qiellit, ashtu siç ndriçojnë yjet për banorët e tokës".³⁴

قَالَ الرِّضَا عَلَيْهِ السَّلَامُ : عَلَيْكُمْ بِصَلَاةِ اللَّيْلِ فَمَا مِنْ عَبْدٍ يَقُومُ آخِرَ اللَّيْلِ فَيُصَلِّي ثِنَانَ رَكَعَاتٍ وَرَكَعَتَيِ الشُّفْعِ وَرَكَعَةَ الْوُتْرِ وَاسْتَغْفَرَ اللَّهَ فِي قُنُوتِهِ سَبْعِينَ مَرَّةً إِلَّا أُجِبَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ عَذَابِ النَّارِ، وَمُدَّةَ فِي عُمُرِهِ، وَوُسْعَ عَلَيْهِ فِي مَعِيشَتِهِ، ثُمَّ قَالَ عَلَيْهِ السَّلَامُ: إِنَّ الْبَيْتُ الَّذِي يُصَلِّي فِيهَا بِاللَّيْلِ يَزْهَرُ نُورُهَا لِأَهْلِ السَّمَاءِ كَمَا يَزْهَرُ نُورُ الْكُوَاكِبِ لِأَهْلِ الْأَرْضِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 161).

³⁴ "Biharul Enuar", vëll. 87, f. 161.

Hadithi 24

Frytet e namazit të natës

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *“Namazi i natës është kënaqësi e Allahut, dashuri e engjëjve, traditë e profetëve, dritë e njohjes, themel i besimit, pushim për trupin, neveri për shejtanin, armë kundër armiqve, shkak për pranimin e lutjes, pranim i veprave dhe begati në furnizim. Ai është ndërmjetësues mes atij që e fal dhe engjëllit të vdekjes, është dritë në varrin e tij, shtrat nën të, përgjigje ndaj Munkerit dhe Nekirit, shoqërues*

dhe vizitor i tij në varr deri në Ditën e Kiametit".³⁵

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: صَلَاةُ اللَّيْلِ مَرْضَاةُ الرَّبِّ، وَحُبُّ الْمَلَائِكَةِ، وَسُنَّةُ الْأَنْبِيَاءِ، وَنُورُ الْمَعْرِفَةِ، وَ أَصْلُ الْإِيمَانِ، وَ رَاحَةُ الْأَبْدَانِ، وَكَرَاهِيَةُ الشَّيْطَانِ، وَسِلَاحٌ عَلَى الْأَعْدَاءِ، وَ إِبَاقَةٌ لِلدُّعَاءِ، وَقَبُولُ الْأَعْمَالِ، وَبَرَكَاتٌ فِي الرِّزْقِ، وَشَفِيعٌ بَيْنَ صَاحِبِهَا وَبَيْنَ مَلِكِ الْمَوْتِ، وَ سِرَاجٌ فِي قَبْرِهِ وَ فِرَاشٌ تَحْتَ جَنْبِهِ، وَجَوَابٌ مَعَ مُنْكَرٍ وَ نَكِيرٍ، وَمُؤَيِّسٌ وَزَائِرٌ فِي قَبْرِهِ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 161).

³⁵ "Biharul Enuar", vëll. 87, f. 161.

Hadithi 25

Namazi i natës, çmimi i Xhenetit

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Përhapeni selamin, ushqeni njerëzit dhe falni namaz natën, ndërsa njerëzit janë në gjumë, që të hyni në Xhenet me paqe”.³⁶

قَالَ عَلِيُّ عَلَيْهِ السَّلَامُ: أَفْشُوا السَّلَامَ، وَأَطْعِمُوا الطَّعَامَ، وَصَلُّوا بِاللَّيْلِ وَالنَّاسَ نِيَامًا، تَدْخُلُوا الْجَنَّةَ بِسَلَامٍ. (بخار الأنوار، ج 87، ص 159).

³⁶ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 159.

Hadithi 26

Namazi i natës dhe siguria e shoqërisë

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur Allahu i Madhëruar dëshiron t'i godasë banorët e tokës me dënim, thotë: ‘Sikur të mos ishin ata që duhen për madhështinë Time, që i gjallërojnë xhamitë e Mia dhe kërkojnë falje në kohët e agimit, do ta zbrisja mbi ta dënimin Tim’”.³⁷

قَالَ عَلِيُّ عَلَيْهِ السَّلَامُ: إِنَّ اللَّهَ عَزَّوَجَلَّ إِذَا أَرَادَ أَنْ يُصِيبَ أَهْلَ الْأَرْضِ بِعَذَابٍ قَالَ لَوْلَا الَّذِينَ يَتَحَابُّونَ بِلَالِي، وَيَعْمُرُونَ مَسَاجِدِي وَيَسْتَغْفِرُونَ بِالْأَشْحَارِ لَأَنْزَلْتُ بِهِمْ عَذَابِي.
(بخار الأنوار، ج 87، ص 150).

³⁷ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 150.

Hadithi 27

Ndriçimi i varrit

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “*Namazi i natës, për atë që e fal, është një llambë në errësirën e varrit*”.³⁸

قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: صَلَاةُ اللَّيْلِ سِرَاجٌ لِصَاحِبِهَا فِي ظُلْمَةِ الْقَبْرِ.
(بخار الأنوار، ج 87، ص 161).

³⁸ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 161.

Pengesat e namazit të natës

Hadithi 28

Privimi nga namazi i natës

Një burrë erdhi te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) dhe i tha: “O Prijësi i besimtarëve, jam privuar nga namazi i natës”. Prijësi i besimtarëve i tha: “Ti je një njeri të cilin mëkatet e tua e kanë lidhur me pranga”.³⁹

جاء رَجُلٌ إِلَى أَمِيرِ الْمُؤْمِنِينَ عَلَيْهِ السَّلَامُ فَقَالَ: يَا أَمِيرَ الْمُؤْمِنِينَ إِنِّي قَدْ حُرُمْتُ الصَّلَاةَ بِاللَّيْلِ، فَقَالَ أَمِيرُ الْمُؤْمِنِينَ: أَنْتَ رَجُلٌ قَدْ قَيَّدَتْكَ ذُنُوبُكَ. (بخار الأنوار، ج 87، ص 146).

³⁹ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 146.

Hadithi 29

Gënjeshtra dhe namazi i natës

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Njeriu mund të thotë një gënjeshtrë dhe për shkak të saj të privohet nga namazi i natës. Kur privohet nga namazi i natës, për shkak të saj, privohet edhe nga furnizimi”.⁴⁰

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ: إِنَّ الرَّجُلَ لَيَكْذِبُ الْكَذِبَةَ فَيُحْرَمُ بِهَا صَلَاةَ اللَّيْلِ، فَإِذَا حُرِمَ بِهَا صَلَاةَ اللَّيْلِ حُرِمَ بِهَا الرِّزْقُ. (بخار الأنوار، ج 87، ص 149).

⁴⁰ “Biharul Enuar”, vëll.87, f. 146.

Hadithi 30

Mëkati dhe namazi i natës

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Njeriu bën një mëkat dhe, për shkak të tij, privohet nga namazi i natës. Me të vërtetë, vepra e keqe ndikon te njeriu më shpejt sesa thika në mish”.⁴¹

قَالَ الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ : إِنَّ الرَّجُلَ يَذْنُبُ الذَّنْبَ فَيُحْزَمُ صَلَاةَ اللَّيْلِ، وَإِنَّ الْعَمَلَ السَّيِّئَ أَسْرَعُ فِي صَاحِبِهِ مِنَ النَّيِّكِينَ فِي اللَّحْمِ. (ميزان الحكمة، ج 10467/5).

⁴¹ “Mijzanul Hikmeh”, vëll. 5, Hadithi 10446.

Hadithi 31

I privuari i vërtetë

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “O Sulejman, mos e lër namazin e natës, sepse i humbur dhe i privuar është ai që është privuar nga ngritja gjatë natës”.⁴²

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ: يَا سُلَيْمَانُ لَا تَدَعْ قِيَامَ اللَّيْلِ فَإِنَّ الْمُعْبُودَ مَنْ حُرِمَ قِيَامَ اللَّيْلِ.
(بحار الأنوار، ج 87، ص 146).

⁴² “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 146.

Etiketa e namazit të natës

Hadithi 32

Namazi i natës në vetmi

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *“Namazi vullnetar që falet në një vend ku askush nga njerëzit nuk e sheh atë që falet, është i barabartë me njëzet e pesë namaze të falura në një vend ku njerëzit e shohin atë”*.⁴³

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ قَالَ: صَلَاةُ التَّطَلُّعِ حَيْثُ لَا يَرَاهُ مِنْ النَّاسِ أَحَدٌ مِثْلُ
خَمْسٍ وَعَشْرِينَ صَلَاةً حَيْثُ يَرَاهُ النَّاسُ. (كنز العمال، 21346/7)

⁴³ “Kenzul Ummal”, vwll. 7, hadithi 21346.

Hadithi 33

Etiketa e namazit të natës

Ali ibn Esbati e pyeti Imam Sadikun (Paqja qoftë mbi të!) për një burrë që ngrihet në fund të natës dhe e ngre zërin gjatë leximit. Ai (Paqja qoftë mbi të!) tha: “Është e përshtatshme që njeriu, kur fal namaz natën, ta ngrejë zërin aq sa ta dëgjojë familja e tij, në mënyrë që ai që është në gjumë, të zgjohet dhe ai që dëshiron të ngrihet, të ngrihet”.⁴⁴

عَنْ عَلِيِّ بْنِ أَصْبَاطٍ: أَنَّهُ سَأَلَ أَبَا عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ عَنْ رَجُلٍ يَقُومُ فِي آخِرِ اللَّيْلِ يَرْفَعُ صَوْتَهُ بِالْقِرَاءَةِ، قَالَ: يَنْبَغِي لِلرَّجُلِ إِذَا صَلَّى بِاللَّيْلِ أَنْ يُسْمِعَ أَهْلَهُ لِكَيْ يَقُومَ النَّائِمُ وَ يَتَحَرَّكَ الْمُتَحَرِّكُ . (بحار الأنوار، ج 87، ص 209).

⁴⁴ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 209.

Hadithi 34

Namazi i natës me familjen

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Kur burri e zgjon familjen e tij gjatë natës dhe ata falin namaz, të dy shkruhen prej burrave dhe grave që e përmendin shumë Allahun”.⁴⁵

عَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ: إِذَا أَبْقَطَ الرَّجُلُ أَهْلَهُ مِنَ اللَّيْلِ وَصَلَّى كُتِبَ مِنَ الذَّاكِرِينَ
اللَّهُ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 158).

⁴⁵ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 158.

Hadithi 35

Misvaku për namazin e natës

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur të ngrihesh natën, përdor misvak, sepse një engjëll vjen dhe vendos gojën e tij mbi gojën tënde. Nuk ka asnjë shkronjë që e lexon dhe e shqipton, veçse ai e ngre atë drejt qiellit. Prandaj le të jetë goja jote e pastër dhe me aromë të mirë.”⁴⁶

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ : إِذَا قُمْتَ بِاللَّيْلِ فَاسْتَكْ فَرَأَى الْمَلَكَ يَأْتِيكَ فَيَضَعُ فَاهُ عَلَى فَيْكِ، فَلَيْسَ مِنْ حَرْفٍ تَتْلُوهُ وَتَنْطِقُ بِهِ إِلَّا صَعِدَ بِهِ إِلَى السَّمَاءِ، فَلْيَكُنْ فَوْكَ طَيِّبَ الرَّيْحِ.
(بحار الأنوار، ج 87، ص 207).

⁴⁶ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 207.

Hadithi 36

Kunuti i gjatë

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: “Më i qeti prej jush në vendqëndrimin e Ditës së Kiametit do të jetë ai që e ka kunutin e vitrit më të gjatë”.⁴⁷

قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: أَطْوَلُكُمْ قُنُوتًا فِي الْوُثْرِ أَطْوَلُكُمْ رَاحَةً يَوْمَ الْقِيَامَةِ فِي الْمَوْقِفِ.
(بحار الأنوار، ج 87، ص 287).

⁴⁷ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 287.

Hadithi 37

Namazi i natës i udhëtarit

Ibrahim ibn Sejabë tregon: “Një pjesëtar i familjes sime i shkroi Imam Ebu Muhamedit, Imam Hasan Askeriut (Paqja qoftë mbi të!), duke e pyetur për namazin e natës së udhëtarit në fillim të natës. Ai i u përgjigj: ‘Vlera e namazit të natës së udhëtarit në fillim të natës është si vlera e namazit të natës të atij që nuk është udhëtar, kur e fal atë në fund të natës’”.⁴⁸

عَنْ إِبْرَاهِيمَ بْنِ سَيَابَةَ قَالَ: كَتَبَ بَعْضُ أَهْلِ بَيْتِي إِلَى أَبِي مُحَمَّدٍ عَلَيْهِ السَّلَامُ فِي صَلَاةِ الْمُسَافِرِ أَوَّلَ اللَّيْلِ فَكَتَبَ عَلَيْهِ السَّلَامُ: فَضَّلُ صَلَاةَ الْمُسَافِرِ أَوَّلَ اللَّيْلِ كَفَضْلِ صَلَاةِ الْمُقِيمِ فِي الْخَضِرِ مِنْ آخِرِ اللَّيْلِ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 210).

⁴⁸ “Biharul Enuar”, vëll. 78, f. 210.

Hadithi 38

Kaza-ja e namazit të natës

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) ka thënë: *“Allahu krenohet me robin që e fal gjatë ditës namazin e natës që i ka mbetur pa falur dhe thotë: ‘O engjëjt e Mi! Robi Im po kryen kaza diçka që Unë nuk ia kam bërë detyrim. Jini dëshmitarë se e kam falur atë’”*.⁴⁹

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: إِنَّ اللَّهَ يُبَاهِي بِالْعَبْدِ يَقْضِي صَلَاةَ اللَّيْلِ بِالنَّهَارِ، يَقُولُ،
مَلَائِكَتِي عَبْدِي يَقْضِي مَا لَمْ أَفْتَرِضْهُ عَلَيْهِ، اشْهَدُوا أَنِّي قَدْ عَفَرْتُ لَهُ. (بحار الأنوار، ج
87، ص 202).

⁴⁹ “Biharul Enuar”, vëll. 87, f. 202.

Hadithi 39

Mënyra e kërimit të faljes në namazin e natës

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kërko falje, shtatëdhjetë herë, nga Allahu në namazin e vitrit. Ngrije dorën e majtë dhe me dorën e djathtë numëro kërkimet e faljes. Edhe i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) kërkonte falje shtatëdhjetë herë në namazin e vitrit dhe shtatë herë thoshte: ‘هَذَا مَقَامُ الْعَائِدِيكَ مِنَ النَّارِ’ - hadha mekamul aidhibike minen nar - ‘Ky është

*vendi i atij që kërkon strehim tek Ti nga
zjarri'''*.⁵⁰

قَالَ أَبُو عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ : اسْتَغْفِرِ اللَّهَ فِي الْوَتْرِ سَبْعِينَ مَرَّةً، تَنْصُبُ بِدَكَ الْيُسْرَى وَتَعُدُّ بِالْيُمْنَى الْأَسْتِغْفَارَ. وَكَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ يَسْتَغْفِرُ فِي الْوَتْرِ سَبْعِينَ مَرَّةً وَيَقُولُ: «هَذَا مَقَامُ الْعَائِذِيكَ مِنَ النَّارِ» سَبْعَ مَرَّاتٍ. (بحار الأنوار، ج 87، ص 202).

⁵⁰ "Biharul Enuar", vëll. 78, f. 287.

Hadithi 40

Vazhdimësia në namazin e natës

Ebu Ja'la transmeton se Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Që nga dita kur dëgjova fjalën e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!): ‘Namazi i natës është dritë’, nuk e kam lënë namazin e natës”. Ibn el-Kauva e pyeti: “As në natën e Haririt?” Ai u përgjigj: “As në natën e Haririt”.⁵¹⁻⁵²

⁵¹ Nata e Haririt është emërtimi i natës gjatë së cilës u zhvillua një betejë e ashpër mes Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) dhe Muavijes.

⁵² “Biharul Enuar”, vëll. 41, f. 17.

أَبُو يَعْلَى فِي الْمُسْتَدَرِّكِ أَنَّهُ (عَلَيْهِ السَّلَام) قَالَ: مَا تَرَكَتُ صَلَاةَ اللَّيْلِ مُنْذُ سَمِعْتُ قَوْلَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: «صَلَاةُ اللَّيْلِ نُورٌ»، فَقَالَ ابْنُ الْكَوَّازِ: وَلَيْلَةُ الْهَرِيرِ؟ قَالَ: وَلَيْلَةُ الْهَرِيرِ.

<https://www.hadithlib.com/>

PËRMBAJTJA

Rëndësia e Namazit të Natës5

Namazi i natës në Kur'an7

*Një urdhër i veçantë për Profetin Muhamed
(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe
familjen e tij!)10*

*Çfarë ka thënë Profeti Muhamed (Paqja e
bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e
tij!)?12*

*Namazi i natës në fjalët e Ehli Bejtit (Paqja
qoftë mbi ta!)15*

Namazi i natës dhe pastrimi i shpirtit19

40 HADITHE RRETH NAMAZIT TË NATËS.....	24
Rëndësia e namazit së natës	25
Dashuria ndaj namazit të natës	25
Stolia e Botës së Përtejme	26
Shenja e dashurisë së Allahut	27
Shkak i lumturisë.....	28
Namazi më i mirë	29
Më i vlefshëm se bota.....	30
Dyert e mirësisë dhe të lumturisë	31
Porosia e Xhebrailit	33
Një prej tri krenarive	34
Nderi dhe madhështia e besimtarit	35
Krenaria e Allahut ndaj engjëjve	36

Shpërblim pa kufi.....	38
Edhe një rekat.....	40
Ndjekësit e Ehli Bejtit dhe namazi i natës.....	41
Zgjimi për namaz	42
Nijeti për namazin e natës.....	44
Ndikimet e namazit të natës dhe shlyerja e mëkateve	45
Dobitë e namazit të natës dhe shlyerja e gjynaheve.....	46
Dobitë e namazit të natës	46
Ndikimet e namazit të natës	47
Namazi i natës dhe drita e Allahut.....	48
Siguria e furnizimit	49

Shkallët e namazit të natës	50
Begatia e namazit të natës	52
Frytet e namazit të natës.....	54
Namazi i natës, çmimi i Xhenetit	56
Namazi i natës dhe siguria e shoqërisë	57
Ndriçimi i varrit.....	58
Pengesat e namazit të natës.....	59
Privimi nga namazi i natës.....	59
Gënjeshttra dhe namazi i natës.....	60
Mëkati dhe namazi i natës	61
I privuari i vërtetë.....	62
Etiketa e namazit të natës	63
Namazi i natës në vetmi	63

Etiketa e namazit të natës.....	64
Namazi i natës me familjen.....	65
Misvaku për namazin e natës	66
Kunuti i gjatë.....	67
Namazi i natës i udhëtarit.....	68
Kaza-ja e namazit të natës	69
Mënyra e kërkimit të faljes në namazin e natës.....	70
Vazhdimësia në namazin e natës	72
PËRMBAJTJA.....	74

إسم الكتاب: اربعون حديثا عن صلاة الليل

الاعداد: مركز نون للتأليف والترجمة

المترجم: صرييه فزا

التصحيح الادبي: يريما كولا

التصحيح اللغوى: الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا

الإخراج النهائي: صرييه فزا

الغلاف: صرييه فزا

الناشر: موسسه قرآن

تيرانا- البانيا- 2026